

Statuti i Asociacionit të Komunave të Kosovës

1. Dispozitat e përgjithshme

- 1.1. Asociacioni i Komunave të Kosovës (në tekstin e mëtejme asociacioni) është organizatë joprofitabile dhe është person juridik që i përfaqëson interesat e përgjithshme të anëtarëve të saj – autoritetet lokale.
- 1.2. Asociacioni e ka lirinë e veprimit, të drejtën e iniciativave të kushtetutës (kornizës ligjore) dhe në bazë të ligjeve tjera. Aktivitetet e asociacionit janë të bazuara në parimet e vullnetarizmit të anëtarëve të saj, në parimet e demokracisë dhe në parimet e decentralizimit të pushtetit.
- 1.3. Anëtarë të asociacionit janë autoritetet lokale të Kosovës.
- 1.4. Autoritetet lokale anëtarësohen në asociacion nga kuvendi i asociacionit pas vendimit të marrë nga Kuvendi Komunal.
- 1.5. Emërtimi i asociacionit është: ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS; akronimi AKK / THE ASSOCIATION OF MUNICIPALITIES OF KOSOVO; akronimi AMK / ASOCIJACIJA OPŠTINA KOSOVA / AOK
- 1.6. Asociacioni ka xhirollogarinë e vet, emblemen në të cilin shkruan: Asociacioni i Autoriteteve Lokale të Kosovës – Kosovë.
- 1.7. Kohëzgjatja e aktiviteteve të asociacionit nuk është i kufizuar.
- 1.8. Selia e asociacionit është në: Prishtinë

2. Objektivat dhe detyrat e asociacionit

- 2.1. Asociacioni angazhohet që në Kosovë të implementohen rregullat nga Karta Evropiane për qeverisjen lokale; të organizoj dhe koordinoj aktivitetet e anëtarëve të asociacionit në sferën e investimeve, në zhvillimin ekonomik të komunave, në përmirësimin e bazës ligjore, të përkrahjes së biznesit, në preventivë dhe kundër krimit, në kulturë, arsim, shkencë, mbrojtje shëndetësore, në çështje sociale dhe përkrahjes sociale, në zgjidhjen e konflikteve, në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe në raportet me asociacionet simotra jashtë shtetit dhe me organizatat ndërkombëtare.
- 2.2. Asociacioni kryen:
 - 2.2.1. inicon, organizon dhe promovon kooperimin në mes autoriteteve lokale të Kosovës, bën zgjidhjen e problemeve të përgjithshme të autoriteteve lokale, nxjerrë materiale metodologjike të cilat ua jep autoriteteve lokale;
 - 2.2.2. harmonizon rregulloret dhe aktet tjera legale që kanë të bëjnë me qeverisjen;
 - 2.2.3. bën asistencë organizative dhe ligjore për autoritetet lokale;
 - 2.2.4. përfaqëson interesat e përgjithshme profesionale të autoriteteve dhe shërbimeve civile nga autoritetet lokale;
 - 2.2.5. përfaqëson interesat e anëtarëve të saj para autoriteteve të jashtme dhe organizatave ndërkombëtare dhe ndihmon autoritetet lokale që te koepërojnë me partnerët e jashtëm;
 - 2.2.6. organizon dhe koordinon trajnime profesionale të autoriteteve politike dhe shërbyesve civil nga radhët e autoriteteve lokale;
 - 2.2.7. organizon dhe koordinon qarkullimin e informacioneve për anëtarët e vet dhe nxjerr publikime të veta;
 - 2.2.8. krijon fonde, hap zyra përfaqësimi, institucione publike;
 - 2.2.9. kryen shërbime të tjera për anëtarët e vet.

3. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësia e anëtarëve të asociacionit

3.1. Anëtarët e asociacionit kanë të drejtë:

3.1.1. të pajisen lirisht me informata, të kenë asistencë metodologjike dhe shërbime tjera;

3.1.2. të bëjnë propozime në asociacion për zhvillimin e vetëqeverisjes dhe për aktivitete të asociacionit;

3.1.3. të delegojnë përfaqësuesit në kuvend të asociacionit dhe të zëvendësojnë ata në pajtim me dispozitat 4.3. dhe 4.4. Anëtarët kanë të drejtë të emërohen, zgjedhen dhe të zgjedhin për detyra menaxhimi edhe në organet e kontrollit të asociacionit.

3.1.4. Këshilli komunal nga autoritetet lokale mund të merr vendim që të tërhiqet nga anëtarësimi në asociacion. Para tërheqjes nga anëtarësia, komuna (autoritetet lokale) obligohet të paguajë anëtarësinë për kohën e kaluar – kohën për sa ishte anëtarë.

3.2. Anëtarët e asociacionit kanë obligim të:

3.2.1. i paguajnë 30.000 DM. në muaj në bazë të numrit të lejuar që kanë komunat;

3.2.2. t'i respektojnë rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të asociacionit dhe këshillit;

3.3. Me rekomandimin e Këshillit të asociacionit, Kuvendi i asociacionit mund të përjashtoj anëtarin e asociacionit, i cili ka shkelur dispozitat e rregullores dhe vendimi për përjashtim duhet të merret me 2/3 e votave të gjithë anëtarëve. Nëse nuk ka paguar anëtarësinë mbetet vetëm vëzhgues në Kuvendin e asociacionit.

4. Organet udhëheqëse, procedura e themelimit, organizimi i procesit të vendosjes, funksionet, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë

4.1. Organet e udhëheqjes (qeverisëse) të asociacionit janë: Kuvendi, Këshilli, Bordi dhe Administra.

4.2. Organi më i lartë i qeverisjes së asociacionit është Kuvendi të cilin e përbëjnë të gjithë anëtarët e asociacionit. Në Kuvend marrin pjesë edhe përfaqësuesit e minoriteteve në pajtim të një marrëveshjeje të kryetarëve të komunave (numri dhe përkatësia). Kërkohet edhe përfaqësimi i partive politike.

4.3. Autoritetet lokale (këshillat komunale) e delegojnë për çdo 10 këshilltar 1 (një) përfaqësues në asociacion.

4.4. Autoritetet lokale do t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e asociacionit, në proporcion me numrin e votave që partia i ka fituar në këshillin komunal. Përfaqësuesit (anëtarët e kuvendit) mund të zëvendësohen me vendim të Këshillit Komunal, por në bazë të dispozitave 4.3. të këtij akti. Përfaqësuesit në Kuvend, pas çdo procesi elektoral të nivelit komunal do të ndërrohen, sipas procedurës së përshkruar në pikën e mëparme.

4.5. Kuvendi i rregullt do të mbahet jo më vonë se tre muaj pas zgjedhjeve lokale dhe shpalljes së rezultatit të tyre, Kuvendi do të mbledhet së paku një herë në vit. Mbledhjet i thërret dhe udhëheq me to Kryetari i Kuvendit, i cili propozon edhe rendin (agjendën) e ditës të cilin e aprovon Kuvendi.

4.6. Vendi i mbajtjes, data dhe rendi i ditës do të shpallet 2 muaj para mbledhjes. Të gjitha materialet do t'u dërgohen anëtarëve të Kuvendit jo më vonë se një javë para mbledhjes.

4.7. Mbledhjet e paparapara (të jashtëzakonshme) të Kuvendit mund të konvokohen së paku një muaj pas paralajmërimit dhe kur për këtë e kanë dhënë pëlqimin 2/3 e anëtarëve.

4.8. Mbledhja dhe vendimet do të konsiderohen të plotëfuqishme, nëse në mbledhje kanë marrur pjesë më shumë se gjysma e numrit të anëtarëve. Vendimet janë të plotëfuqishme, nëse merren me shumicën e thjeshtë të votave nga anëtarët prezent dhe votimi bëhet në mënyrë të hapur.

4.9 Rregulloret e asociacionit aprovohen dhe plotësohen me votim të hapur dhe me 2/3 e votave nga anëtarët prezent në kuvend. Votimi është i hapur.

4.10. Kryetari dhe Nënkryetarët zgjedhen me shumicën e thjeshtë të votave gjatë votimit të hapur.

- 4.11. Pushimi i punës së asociacionit bëhet me vendim të Kuvendit dhe konsiderohet se asociacioni është shuar kur për këtë kanë votuar 2/3 e anëtarëve me votim të hapur.
- 4.12. Kuvendi kryesohet nga Kryetari, të cilin e zgjedh kuvendi. Procesverbalet i mban sekretari. Mandati i Kryetarit është dy vjetë me të drejtë të zgjedhjes edhe një mandat.
- 4.13. Kuvendi miraton vendime për çështje në bazë të agjendës së aprovuar.
- 4.14. Kuvendi i asociacionit kryen:
- 4.14.1. aprovon rregulloren e punës së asociacionit si dhe amendamentet në këtë rregullore;
 - 4.14.2. konfirmon dhe ndërron shumën e pagesës për anëtarësi;
 - 4.14.3. pranon anëtarë të rinj dhe shkarkon-largon anëtarë në pajtim me dispozitat 1.4. dhe 3.3.;
 - 4.14.4. aprovon dhe vlerëson shpenzimet e asociacionit, dhe në rast nevoja e thërret Këshillin që këtë ta bëjë më fleksibile;
 - 4.14.5. përcakton prioritetin e aktiviteteve dhe detyrave për asociacionin;
 - 4.14.6. zgjedh komisionet e asociacionit;
 - 4.14.7. zgjedh kryetarin dhe dy nënkryetarët e asociacionit;
 - 4.14.8. shqyrton raportet e komisioneve;
 - 4.14.9. miraton vendimet për anëtarësim në ndonjë organizatë të pavarur ndërkombëtare;
 - 4.14.10. aprovon simbolet e asociacionit;
 - 4.14.11. merr vendim për pushimin e punës së asociacionit dhe emëron komisionin për likuidim të asociacionit;
 - 4.14.12. zgjedh nga anëtarësia e tij anëtarët e Bordit dhe i shkarkon.
- 4.15. Në periudhën mes dy kuvendeve, Kuvendi i Asociacionit do të administrohet nga këshilli, i cili përbëhet nga kryetarët e komunave. Këshilli do të mbledhet së paku çdo tre muaj. Mbledhjet e Këshillit kryesohen nga kryetari i asociacionit, i cili në të njëjtën kohë nënshkruan të gjitha vendimet e këshillit.
- 4.15.1. Këshillin e përbëjnë kryetarët e komunave dhe anëtarët e Bordit.
- 4.16. Mbledhjet e Këshillit dhe vendimet konsiderohen të plotfuqishme, nëse në mbledhje kanë marrë pjesë më shumë se gjysma e numrit të anëtarëve të këshillit. Vendimet merren me vota të hapura dhe me shumicën e anëtarëve prezent. Nëse votimi është ndarë në dysh, vota e kryesuesit e përcakton vendimin.
- 4.17. Këshilli i asociacionit kryen:
- 4.17.1. me rekomandim të bordit analizon aktet dhe projekt vendimet (projekt rezolutat) që janë të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetet e autoriteteve lokale;
 - 4.17.2. aprovon programin e aktiviteteve dhe llogarinë përfundimtare të asociacionit;
 - 4.17.3. konfirmon marrëveshjet e asociacionit;
 - 4.17.4. analizon çështjet e propozuara nga bordi dhe çështjet e propozuara nga anëtarët e këshillit, dhe për këtë merr vendime të caktuara;
 - 4.17.5. shqyrton aktivitetet financiare të asociacionit dhe shqyrton marrëveshjet e punës me anëtarët e komisioneve dhe fikson pagat e tyre;
 - 4.17.6. shqyrton raportet e bordit dhe të komisioneve;
 - 4.17.7. vendos, rregullon dhe riorganizon e shlyen fondet;
 - 4.17.8. kryen edhe funksione tjera të përcaktuara nga kuvendi i asociacionit.
- 4.18. Bordi i asociacionit zgjidhet nga anëtarët e kuvendit të asociacionit. Bordi përbëhet prej 7 anëtarëve: kryetari, dy nënkryetarë (njëri prej tyre duhet të jetë i nacionalitetit serb), sekretari dhe tre anëtarë tjerë. Duhet të respektohet përfaqësimi i partive politike. Bordi do të mbledhet së paku një herë në muaj. Bordi mbledhet me thirrje të kryetarit të asociacionit, i cili edhe kryeson me mbledhje dhe nënshkruan të gjitha vendimet e marrura.
- 4.19. Bordi i asociacionit kryen:
- 4.19.1. diskuton problemet e ngritura në mbledhje të Kuvendit, të Këshillit, të kryetarëve dhe ofron zgjidhjet-propozimet;
 - 4.19.2. bën propozime dhe vërejtje, të cilat ja drejton organeve të pushtetit dhe qeverisë lidhur me përmirësimin e vetqeverisjes;

- 4.19.3. përcakton detyrat e obligueshme për administratën, përcakton strukturën e administratës, përcakton listën e stafit dhe specifikon e vlerëson shpenzimet;
- 4.19.4. shqyrton planin e aktiviteteve dhe raportin e administratorit;
- 4.19.5. konfirmon dhe përcakton listën e komisioneve dhe rregulloret;
- 4.19.6. pranon dhe shkarkon drejtuesin e administratës përmes rrugës së konkurrencës së hapur (konkursit);
- 4.20. Vendimi në bord konsiderohet i plotëfuqishëm nëse për të kanë votuar më shumë se gjysma e numrit të anëtarëve të bordit.
- 4.21. Këshilli dhe bordi i asociacionit vendosin nëse është i nevojshëm krijimi i organeve të ndryshme konsultative (grupe punuese, institucione të vetëqeverisjes nëpër zona, etj.)
- 4.22. Në mbledhjet e rajonit marrin pjesë kryetarët e rajonit dhe mbahen sipas nevojës.
- 4.23. Mbledhjet kryesohen nga një kryesues që zgjedhet në mbledhje. Orari dhe rendi i ditës përcaktohet me marrëveshje. Në mbledhje diskutohen çështjet urgjente për autoritetet lokale të rajonit dhe këto pastaj i përcjellen Bordit përmes të autorizuarit. Pjesëmarrësit në mbledhje mund të autorizohen që propozimet t'i përcjellin drejtpërdrejt në bord.
- 4.24. Mandati i kryetarit dhe nënkryetarëve fillon që nga dita e zgjedhjes në mbledhjen e kuvendit. Mandati i anëtarëve të Bordit është 2 vjetë me të drejtë të zgjedhjes edhe një mandat. Në rast se kryetari dhe nënkryetarët ndërrojnë pozitat e tyre apo tërhiqen nga aktivitetet në sistemin e autoriteteve lokale, atëherë edhe funksionet e tyre pushojnë. Në këtë rast këto funksione Këshilli ua beson anëtarëve të Këshillit deri në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit.
- 4.25. Kryetari i asociacionit kryen:
- 4.25.1. organizon punën e institucioneve menaxhuese të asociacionit;
- 4.25.2. përfaqëson asociacionin para organeve shtetërore: para presidentit, qeverisë, organizatave të pavarura ndërkombëtare dhe koordinon punën e autoriteteve lokale;
- 4.25.3. definojnë përgjegjësitë, autorizimet dhe kompetencat e nënkryetarëve;
- 4.25.4. me autorizim të këshillit nënshkruan marrëveshje;
- 4.25.5. siguron kontinuitetin e aktiviteteve të asociacionit gjatë zgjedhjes së anëtarëve të rinj si përfaqësues të autoriteteve lokale pas zgjedhjeve të reja lokale;
- 4.26. Aktivitetet e asociacionit do të organizohen nga administrata që përcakton rregullat teknike për trupat menaxhuese të administratës. Administrata udhëheqet nga drejtuesi i administratës. Administrata punon në bazë të Igjit, në bazë të rregulloreve për përgjegjësinë të aprovuar nga Kuvendi, në bazë të vendimeve të Kuvendit, të vendimeve të Këshillit, të Bordit dhe në bazë të urdhërave të drejtorit të administratës.
- 4.27. Drejtuesi i administratës kryen:
- 4.27.1. organizon dhe kryen aktivitetet e përditshme të asociacionit;
- 4.27.2. zgjidh çështjet organizative, ekonomike dhe financiare të administratës;
- 4.27.3. i dorëzon këshillit dhe bordit për shqyrtim planet e punës dhe ato të kontabilitetit dhe i jep informacion anëtarëve të asociacionit për implementimin e vendimeve të kuvendit;
- 4.27.4. përfaqëson asociacionin në gjykata, në raportet me persona tjerë juridik lidhur me kompetencën para organeve lokale dhe institucioneve shtetërore.
- 4.27.5. konstaton aktivitetet ekonomike të administratës;
- 4.27.6. punëson, largon nga puna dhe shqipton masa disiplinore për personelin;
- 4.27.7. hap dhe mbyll xhirollogarinë bankare;
- 4.27.8. autorizon, kur është nevoja, anëtarë të Bordit për të kryer detyra nga kompetenca e tij;
- 4.27.9. nxjerr urdhëresa lidhur me punën e administratës;
- 4.27.10. siguron mbrojtjen e pronave të asociacionit dhe kujdeset për kushte më të mira të punës;
- 4.28. Trupat mbikëqyrëse të Bordit të asociacionit-komisionet e asociacionit formohen nga përbërja e të deleguarve nga autoritetet lokale. Lista e komisioneve të asociacionit do të aprovohet nga Bordi i asociacionit. Aktivitetet e komisioneve janë të bazuara në rregulloret e

asociacionit dhe mbikëqyren e koordinohen nga nënkryetari i asociacionit, ndërsa rregullat teknike kryhen nga administrata.

4.29. Asociacioni zbaton ligjin për gjuhët në Kosovë.

5. Prona, burimet e financimit dhe procedurat për përdorimin e pasurisë

5.1. Prona e asociacionit dhe fondet tjera përbëhen nga:

5.1.1. pagesa e anëtarësisë;

5.1.2. të ardhurat nga publikimet dhe shërbimet;

5.1.3. të hyrat nga shteti dhe nga buxhetet komunale;

5.1.4. të hyrat nga niveli qendror dhe nga jashtë;

5.1.5. fondet nga dhuratat, nga ndihmat, donacionet si dhe fondet e marra nga ndonjë trashëgimi;

5.1.6. të ardhurat nga ndonjë burim tjetër.

5.2. Asociacioni përdor, administron fondet dhe disponon pronën në pajtim me rregulloren e asociacionit dhe me ligjet.

5.3. Prona e asociacionit menaxhohet me përgjegjësi nga drejtori i administratës. Pasuria e asociacionit përdoret vetëm me qëllim të implementimit të realizimit të asociacionit.

6. Kontrolli i aktiviteteve financiare

6.1. Kontrolli i aktiviteteve financiare të asociacionit kryhet nga Komisioni i Financave.

6.2. Komisioni i financave përbëhet prej tre vetash, të cilët i zgjedh kuvendi i asociacionit.

Puna e komisionit fillon ditën e zgjedhjes dhe përfundon kur të zgjedhet komisioni tjetër, pas zgjedhjeve lokale. Me komisioni udhëheq kryesuesi i komisionit. Nëse ndonjëri anëtar i komisionit është larguar nga funksionet në Këshillin Komunal, automatikisht e humb vendin në komision. Në këtë rast Këshilli i Asociacionit e emëron një anëtar të ri, derisa të mbledhet kuvendi ku do të zgjedhet anëtari tjetër.

6.3. Komisioni i financave kryen inspektimin e aktiviteteve financiare të administratës, së paku një herë në vit dhe për këtë i raporton Këshillit të Asociacionit.

6.4. Të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me financat i jepen në shikim, në çdo kohë komisionit të financave.

7. Shuarja e asociacionit

7.1. Asociacioni pushon së ekzistuari me vendim të kuvendit, nëse për këtë kanë votuar më shumë se 2/3 e të gjithë anëtarëve të asociacionit.

7.2. Asociacioni mund të pushojë me vendim të organeve të shtetit (organit që ka regjistruar asociacionin), nëse në asociacion mbesin më pak se gjysma e anëtarëve dhe nëse vendet tjera nuk janë plotësuar brenda një viti.

7.3. Kuvendi, nëse merr vendim për pushimin e asociacionit, duhet të emëroje komisionin për likuidim dhe të përcaktoj detyrat e tij.

7.4. Komisioni i likuidimit obligohet të informoje të gjithë anëtarët e kuvendit lidhur me procedurën e likuidimit.

7.5. Dispozitat e këtij statuti dhe ky statut hyjnë në fuqi me ditën e regjistrimit.

7.6. Statuti është aprovuar në mbledhjen e kuvendit të mbajtur më: 30.06.2001.

8. Të gjitha dokumentet janë në tri gjuhët zyrtare të Kosovës.

Kryetari,
Lutfi Haziri _____